

PROTOKOLL

Mbledhja e pestë e kryesisë së shoqatës e thirrur nga kryetari Ismet Abdyli

Data: 01.09.2018

Ora: 18:00

Vendi: Glattbrugg

Pjesmarrës: Ismet Abdyli, Muhamet Guda, Avni Kastrati, Imran Asllani, Musa Halili ,
Fadil Kqiku

Mungon: Qenan Haziri

Temat e ditës:

1. Bahri Zeqirovci

Kryesia edhe njeher shpreh ngushllime familjareve si dhe te gjithë atyte qe e njohen ish anetarin e kryesis se shoqates tone te shume respektuarin Bahri Zeqirovci. Shoqata ne rastin e vdekjes se ish anetarit te kryesis ka ndare 100 € per blerjen e luleve te fresketa dhe kuroren.

2. Java Kulturore

Java kulturore Doberqani 2018 eshte permyll ne menyre shembullore. Faleminderojm organizatoret per organizimin e mrekullushem. Shoqata kete vite e ka mbeshtet organizimin e javes kuturore me 150€. Gjithashtu permes shoqates Qamil Sadriu ka mbeshtet javen kulturore me 500 CHF. Shoqata gjate javes kulturore ka shperbly Ilir Kastratin me nje loptop pas shume suksese me nxenesit e shkolles tone, gjithashtu profesoret Rexhep Arifi dhe Mirsad Kazazin me nga 100.- € per pune te dalluar ne arsim. Ekipi fitues ishte nga Orange Net nga Doberqani te cilet mposhten ekipin nga Prishtina, Prishtina ishte ekipi me Fair Play dhe u shperbly me 300 CHF.

3. Mbeshtetje per aktivite sportive (Infrasktruktura te stadioni)

Pas kerkeses per ndihme ne rregullimin e kabinave te futbollisteve te Stadion kryesia e shoqates ne parim e perkrah kete kerkes dhe do ta mbeshtes gjithashtu ne te ardhem realizimin e ketij projekti njekohesist kerkon minimum 3 oferta te ndryshme.

4. Punetori i shoqates

Afrim Kastrati ka shpreh deshiren te jete punetori ri per mirmbajten e fshatit. Pas nje kohe te gjate qe nuk kemi te interesuar te tjere per pune, me vendim te kryesis Afrim Kastrati zgjidhet mirembajtessi i ri i shoqates 17shkurti.ch. Kushtet e punes dhe rrogat do te jete si per te gjihe punetoret paraprak.